



FECH

Forum for Educational Change

Faqe të pastra

**Integriteti akademik,
transparenca dhe qëndrueshmëria**

Propozim politikash

**Marina Klimoska
Stefan Atanasovski Trajković**

Supported by



**©2026 Forumi për Ndryshime në Arsim; Форум за образовни промени
(Forum for Educational Change), National Endowment for Democracy (NED)**

Publikues:

FNA - Forumi për Ndryshime në Arsim

Autor:

Marina Klimoska, Stefan Atanasovski Trajković

Përkthyes:

Bardh Zejneli

The research “Clean Pages” has been produced with the support of the National Endowment for Democracy (NED) as part of “Promoting Youth Engagement in Accountability of Public Institutions” project.

Its contents do not necessarily reflect the official opinion of NED. Responsibility for the information and views expressed in this publication lies entirely with the author(s).

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Analizë e gjendjes aktuale_____	3
2. Propozim i strategjive dhe i masave politike_____	7
2.1 Objektivat_____	7
Ndryshimet e dëshiruara në qasjen ndaj politikave_____	8
Efektet e këtyre ndryshimeve_____	9
Tregues të matshëm_____	10
2.2 Strategjia_____	11
2.3 Masat politike_____	11
1. Reformat ligjore dhe rregullatore_____	12
2. Qeverisja institucionale_____	12
3. Transparenca dhe digjitalizimi_____	13
4. Fuqizimi dhe mbrojtja e studentëve_____	14
5. Integriteti dhe mbështetja e hulumtimeve_____	14
3. Zbatimi_____	15
3.1 Periudha kohore_____	15
3.2 Plani i zbatimit_____	16
FAZA I (6 muaj - 1 vit) - Ndërtimi i themeleve_____	16
FAZA II (12 muaj - 24 muaj) - Miratimi dhe zbatimi i plotë_____	16
FAZA III (24 muaj - 36 muaj) - Qëndrueshmëria dhe vlerësimi_____	17
Resurset e nevojshme dhe burimet_____	18
4. Konkluzioni_____	20
5. Referencat_____	21

1. Analizë e gjendjes aktuale

Propozimi i publikimit "Faqe të pastra" është botimi përfundimtar i nismës joformale të udhëhequr nga studentët, e mbështetur nga Forumi për Ndryshime në Arsim (FECH). Kjo nismë adreson korrupsionin në sistemin e arsimit të lartë të Maqedonisë së Veriut, konkretisht praktikën e aktiviteteve nën tavolinë të kërkuara nga profesorët universitarë që shesin tekstet e tyre shkollore si kusht për të pasur sukses në studime.

Sistemi i arsimit të lartë në Maqedoninë e Veriut vepron sipas një kuadri ligjor që ofron udhëzime specifike të kufizuara mbi botimin e teksteve shkollore dhe politika të detyrueshme të literaturës. **Ligji për Arsimin e Lartë**¹ përcakton autonominë universitare dhe lirinë akademike, por nuk rregullon në mënyrë të qartë tekstet shkollore, autorë të cilëve janë profesorët, ose kërkesat e tyre për blerjen obligative të këtyre teksteve. Kjo krijon një boshllëk rregullator, me ç'rast universitetet dhe fakultetet individuale mbajnë autoritet diskrecionar mbi politikat e teksteve shkollore pa kufizime të qarta ligjore.

Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit² ofron kuadrin primar anti-korrupsion të zbatueshëm për universitetet, që kërkon zbardhjen e konflikteve të interesit dhe marrjen e masave për parandalimin e praktikave korruptive. Megjithatë, zbatimi i tij në botimin e teksteve shkollore mbetet jokonsistent nëpër institucione. **Ligji për veprimtarinë shkencore dhe kërkimore**³ rregullon kërkesat themelore të hulumtimit dhe botimit, por në të mungojnë dispozita specifike për botimin akademik në arsimin e lartë në lidhje me këtë çështje.

Infrastruktura e bibliotekës digjitale të UKM-së⁴ ofron qasje në mbi 200 libra elektronikë me qasje të hapur dhe **E-Bibliotekën UKM Access**⁵ në databaza të shumta elektronike, duke përfshirë EBSCO, Cambridge Core dhe OpenEdition. Universiteti merr pjesë në platformën COBISS (Co-operative Online Bibliographic System and Services), e cila mundëson katalogimin e përbashkët në të gjitha bibliotekat e vendit dhe u ofron studentëve qasje në mbi 18,000 revista me tekst të plotë. Por këto burime nuk mbulojnë pjesën më të madhe të literaturës së detyrueshme, të cilën studentët zakonisht e sigurojnë duke bërë marrëveshje të dyshimta me profesorin.

¹ [Закон за високо образование](#)

² [Закон-за-спречување-на-корупцијата-и-судирот-на-интереси.pdf](#)

³ [ЕНЕР | Закон за научно-истражувачката дејност](#)

⁴ [Дигитална библиотека - Универзитет „Св. Кирил и Методиј“ во Скопје](#)

⁵ [e-Library UKM Access - Универзитет „Св. Кирил и Методиј“ во Скопје](#)

Dëshmitë e studentëve përshkruajnë praktikat ku profesorët kërkojnë nga ata blerjen e botimeve të tyre si kusht për të marrë nënshkrime, pikë shtesë ose lehtësira për studentët kur u nënshtrohen provimeve.⁶ Në anketën tonë online Faqe të pastra, ku kanë marrë pjesë 150 studentë të UKM-së, 43% e studentëve thonë se, si kusht për të përparuar në studime, për disa nga lëndët, atyre u është kërkuar të blejnë një libër shkollor origjinal të shkruar nga profesori, ndërsa 18.8% e tyre për shumicën e lëndëve.

Kornizat aktuale kundër korrupsionit nuk kanë mekanizma specifike zbatimi për konfliktet e interesit që lidhen me tekstet shkollore. Ndërsa Ligji për parandalimin e korrupsionit kërkon zbulimin e interesave financiare, zbatimi i tij ndaj honorarëve të teksteve shkollore dhe ndaj blerjeve të detyrueshme nga studentët, mbetet i paqartë dhe zbatohet në mënyrë jokonsistente.

Mekanizmat e brendshëm të UKM-së për sigurim të cilësisë nuk i adresojnë në mënyrë sistematike politikat e botimit ose nuk i monitorojnë konfliktet e mundshme të interesit në çështjet që kanë të bëjnë me nevojat e literaturës. Autonomia në nivel fakulteti në zhvillimin e kurrikulës përfshin autoritetin diskrecionar mbi literaturën e detyrueshme pa mbikëqyrje të centralizuar të shqetësimeve të mundshme etike. Mbikëqyrja e këshillit botues të universitetit përqendrohet kryesisht në cilësinë akademike sesa në konsideratat etike që lidhen me blerjet e detyrueshme të materialeve të autorizuara nga fakulteti.

Financimi i pamjaftueshëm publik për arsimin e lartë krijon presione që mund të kontribuojnë në korrupsionin që lidhet me tekstet shkollore. Rishikimi i Financave Publike të Bankës Botërore 2024⁷ vuri në dukje se shpenzimet për arsim në Maqedoninë e Veriut mbeten nën mesataren rajonale, duke krijuar presione financiare si mbi institucionet ashtu edhe mbi studentët. Për më tepër, investimet publike në kërkim mbeten dukshëm nën mesataren e BE-së (0.38% e PBB-së në Maqedoninë e Veriut krahasuar me 2.27% të PBB-së në BE)⁸.

Sistemit arsimor i mungon transparenca sistematike në politikat e teksteve shkollore dhe praktikat e blerjes. Universitetet nuk publikojnë të dhëna gjithëpërfshirëse mbi kërkesat e teksteve shkollore, kostot ose politikat në lidhje me materialet e autorizuara nga fakulteti.

⁶ [Корупција во високото образование: Продажбата на книги од професори е најчеста коруптивна појава* – Meta.mk](#)

⁷ [World Bank: North Macedonia Public Finance Review](#) p. 133

⁸ [Aligning North Macedonia's Higher Education with European Research & Innovation Trends](#)

Mekanizmat e mbrojtjes së studentëve mbeten të pamjaftueshëm, me kanale formale të kufizuara për raportimin e konflikteve të interesit që kanë të bëjnë me tekstet shkollore pa frikë nga hakmarrjet e mundshme.

Standardet e cilësisë jokonsistente në njësitë universitare ndikojnë si në kriteret e përzgjedhjes së teksteve shkollore ashtu edhe në proceset e vlerësimit. Edhe pse janë krijuar organe të reja të sigurimit të cilësisë, fokusi i tyre në politikat e teksteve shkollore dhe konsideratat etike në përzgjedhjen e literaturës mbetet i pazhvilluar.

Seksionet e mëposhtme të këtij propozimi politikash paraqesin një strategji me masa konkrete dhe një kornizë zbatimi, të hartuar për t'i adresuar këto sfida në një qasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Combating Textbook Corruption in North Macedonia



2. Propozim i strategjive dhe i masave politike

2.1 Objektivat

Ky propozim synon të eliminojë praktikat korruptive të blerjes së teksteve shkollore në arsimin e lartë të Maqedonisë së Veriut duke vendosur rregulla transparente dhe të përqendruara te studentët për përzgjedhjen dhe aksesin në literaturë. Ai synon të sigurojë që studentët të mund të përparojnë në aspektin akademik, pa mos qenë nën trysni që të blejnë materiale të autorizuara nga profesorët, të vendosë rregulla të qarta për konfliktin e interesit rreth botimeve akademike dhe të garantojë akses të përballueshëm në literaturën e kërkuar përmes bibliotekave, platformave digjitale universitare dhe burimeve falas me akses të hapur (free open-access sources).

Po aq e rëndësishme, propozimi synon të nxisë një kulturë kërkimore me integritet. Profesorët dhe hulumtuesit duhet të mbështeten për të prodhuar tekste shkollore dhe punime akademike me cilësi të lartë, pa u mbështetur në praktika informale ose korruptive. Kjo nënkupton dekurajimin e prodhimit të teksteve që janë plagjiat ose me vlerë të ulët dhe krijimin e kushteve që botimi të jetë i përballueshëm, i rishikuar siç duhet dhe në përputhje me standardet evropiane të cilësisë dhe etikës.

Ndryshimet e dëshiruara në qasjen ndaj politikave

Aktualisht, politikat e teksteve shkollore vendosen nga fakultetet ose universitetet individuale me pak mbikëqyrje, ndërsa rregullat kombëtare kundër korrupsionit nuk i mbulojnë në mënyrë eksplicite praktikat e teksteve shkollore. Kjo lë hapësirë për abuzim. Ndryshimi i dëshiruar është një lëvizje drejt një sistemi transparent dhe llogaridhënës ku:

- Konfliktet e interesit të deklarohen dhe të monitorohen sa herë që një profesor e kërkon librin e tij shkollor.
- Të gjitha tekstet shkollore ekzistuese obligative (të detyrueshme) që përdoren aktualisht të jenë të digjitalizuara dhe të vihen në dispozicion përmes platformave digjitale të sigurta universitare, duke siguruar që reformat të zbatohen jo vetëm për botimet e reja, por edhe për materialet që profesorët vazhdojnë të përdorin vit pas viti.
- Studentët gjithmonë të kenë një zgjedhje - çdo libër i kërkuar duhet të jetë i disponueshëm ose në bibliotekë, në platformat digjitale të licencuara të universitetit, ose në një version falas me qasje të hapur (open-access) në internet.
- Organet e pavarura mbikëqyrëse t'i rishikojnë rregullat e teksteve shkollore, në vend që vendimet t'i lënë tërësisht në duart e profesorëve.
- Çdo semester, universitetet të publikojnë informacione të qarta mbi librat e kërkuar, kostot e tyre dhe opsionet e disponueshme të qasjes.
- Të mbështetet cilësia e hulumtimit (kërkimit) — profesorët të inkurajohen të publikojnë me integritet nëpërmjet mbështetjes institucionale për redaktimin, korrekturën dhe botimin me akses të hapur.
- Të vendoset një qasje e unifikuar në të gjitha fakultetet dhe universitetet, duke siguruar që praktikat pozitive, të tilla si sistemet e aksesit digjital, të zbatohen në mënyrë konsistente, në mënyrë që studentët në një fakultet të mos jenë në disavantazh krahasuar me ata në një fakultet tjetër.

Efektet e këtyre ndryshimeve

Nëse zbatohen, këto ndryshime do të zëvendësojnë praktikat e paqarta dhe të kontrolluara nga profesorët me sisteme transparente dhe të drejta. Efektet e pritshme përfshijnë:

- Më shumë integritet dhe besim. Studentët nuk do të ndihen më të detyruar të bëjnë pagesa informale dhe standardet e universiteteve do të përputhen me standardet evropiane të ndershmërisë në arsim.
- Akses i barabartë. Të gjithë studentët, pavarësisht nga të ardhurat, do të jenë në gjendje të përmbushin kërkesat e kursit përmes opsioneve legjitime dhe të përballueshme.
- Mësim më i mirë. Me më pak stres dhe rregulla më të qarta, studentët mund të përqendrohen në studim në vend që të shqetësohen për kostot ose trysnitë.
- Institucione më të forta. Universitetet do të fitojnë procedura dhe mekanizma mbikëqyrës të qëndrueshëm, duke zvogëluar rreziqet e korrupsionit.
- Kulturë kërkimore e përmirësuar. Profesorët do të njihen dhe mbështeten për prodhimin e materialeve cilësore, dekurajimin e plagjiaturës dhe inkurajimin e kontributeve të vërteta në dije.
- Një qasje e unifikuar në të gjitha fakultetet dhe universitetet do të zvogëlojë pabarazitë në përvojat e studentëve, duke siguruar që praktikat më të mira, të tilla si qasja e plotë digjitale, të mos kufizohen vetëm në fakultete specifike, por të bëhen standard kudo.

Tregues të matshëm

- 50% më pak studentë që raportojnë se u është kërkuar të blejnë librin e një profesori në vitin e parë, 80% më pak në vitin e dytë dhe eliminimi i kësaj praktike në vitet në vijim.
- 100% e teksteve shkollore obligative të disponueshme ose në bibliotekë, përmes platformave digjitale universitare, ose në versione falas me akses të hapur.
- Rritja e përqindjes së ankesave të studentëve në lidhje me tekstet shkollore të zgjidhura në mënyrë të drejtë pa hakmarrje çdo vit.
- 100% e fakulteteve të audituara çdo vit për pajtueshmëri me rregullat e teksteve shkollore.
- Ulja e shpenzimeve mesatare vjetore nga studentët për tekstet shkollore obligative.
- Rritja e numrit të profesorëve të mbështetur me grante korigjimi, redaktimi ose botimi, me akses të hapur çdo vit.
- Rritja e përqindjes së studentëve që besojnë se mund të denoncojnë korrupsionin pa frikë.
- Ulja e numrit të teksteve shkollore që janë plagjiaturë ose me cilësi të ulët, të identifikuar çdo vit përmes komisioneve universitare të rishikimit.
- Rritja e numrit të punimeve akademike me cilësi të lartë, të rishikuara nga kolegët ose me akses të hapur, të prodhuara nga profesorët çdo vit.
- Rritja e shpenzimeve publike kombëtare për hulumtim, nga 0.38% e PBB-së aktuale në të paktën 1% në afat të mesëm, me një qëllim afatgjatë për t'iu afruar mesatares së BE-së prej 2.27%.

2.2 Strategjia

Strategjia për luftimin e korrupsionit në arsimin e lartë do të përqendrohet në krijimin e një sistemi transparent dhe të drejtë të politikave të teksteve shkollore përmes reformave të koordinuara ligjore, ndryshimeve institucionale dhe angazhimit publik. Qasja kombinon përditësimet e politikave në nivel kombëtar me reformat brenda universiteteve, të mbështetura me mjete digjitale dhe përpjekje më të gjera të avokimit. Zbatimi do të mbështetet në katër shtylla: përafrimi i ligjeve dhe politikave me rregulla të qarta të konfliktit të interesit, vënia e mekanizmave më të fortë të sigurimit të cilësisë dhe rishikimit brenda universiteteve, zgjerimi i aksesit digjital në tekstet shkollore përmes bibliotekave dhe platformave me akses të hapur, dhe ofrimi i mbështetjes financiare dhe institucionale për profesorët që botojnë me integritet. Këto masa do të shoqërohen me fushata të gjera ndërgjegjësimi të studentëve si dhe të stafit akademik, duke siguruar që të drejtat dhe përgjegjësitë të kuptohen mirë. Pas miratimit, propozimi do të pasohet nga një përpjekje avokimi që do të angazhojë universitetet, organet studentore, OJQ-të, agjencitë anti-korrupsion dhe partnerët ndërkombëtarë si BE-ja dhe OKB-ja, në mënyrë që të sigurohet zbatimi afatgjatë dhe përputhja me standardet evropiane.

2.3 Masat politike

Për të adresuar në mënyrë efektive korrupsionin në praktikën e teksteve shkollore, masat grupohen në pesë kategori: reforma ligjore dhe rregullatore, qeverisja institucionale, transparenca dhe digjitalizimi, fuqizimi dhe mbrojtja e studentëve, dhe integriteti dhe mbështetja e hulumtimit. Së bashku, ato krijojnë një përgjigje ndaj të gjithë sistemit, që zbatohet në të gjitha universitetet publike dhe përputhet me standardet evropiane të drejtësisë dhe integritetit.

1. Reformat ligjore dhe rregullatore

- Të ndryshohet Ligji për Veprimtarinë Botuese, ku shitjet me detyrim të teksteve shkollore të definojnë si shkelje, të kërkohet që tekstet shkollore të autorizuara nga profesorët të depozitohen në bibliotekat universitare (si digjitale ashtu edhe fizike) dhe të aprovohet kontrolli i plagjiaturës dhe origjinalitetit para se ato të miratohen. Të përfshihen edhe sanksione për shkeljet.
- Të ndryshohet Ligji për Arsimin e Lartë, duke iu kërkuar universiteteve të miratojnë rregulla uniforme mbi politikën e teksteve shkollore, konfliktet e interesit dhe sanksionet, duke siguruar zbatim të barabartë në të gjitha universitetet publike.
- Të bëhet linjëzimi (përafrimi) i Statuteve, Kodeve etike dhe i procedurave disiplinore të universiteteve me këto ligje dhe të përfshihen rregullat antikorruption në dokumentet themelore të universitetit.

2. Qeverisja institucionale

- Të ngriten komisione të pavarura të teksteve shkollore në çdo fakultet, duke përfshirë profesorë nga departamente të tjera, stafin e bibliotekës dhe përfaqësuesit e studentëve, për të shqyrtuar dhe miratuar literaturën e obligueshme.
- Të zgjerohet mandati i organeve të sigurimit të cilësisë universitare për të monitoruar politikën e teksteve shkollore dhe konfliktet e interesit, jo vetëm cilësinë e mësimdhënies.
- Fakulteteve t'u kërkohet që të publikojnë raporte vjetore mbi praktikën e teksteve shkollore, konfliktet e interesit dhe sanksionet e aplikuara.

3. Transparenca dhe digjitalizimi

- **Listat publike të teksteve shkollore.** Çdo semestër, universitetet duhet të publikojnë listat e të gjitha teksteve shkollore obligative, autorëve të tyre, çmimeve dhe opsioneve të aksesit në dispozicion.
- **Digjitalizimi i teksteve shkollore ekzistuese.** Lansimi i një programi kombëtar për të skanuar dhe digjitalizuar tekstet shkollore obligative, duke u dhënë përparësi atyre që përdoren në kurset me kërkesë të lartë.
- **Qasje për hyrje në universitet.** Sigurimi i aksesit digjital të mbrojtur me fjalëkalim (password-protected) në tekstet shkollore obligative (për procesin e digjitalizimit të teksteve shkollore ekzistuese) përmes llogarive universitare (email-i i studentit + login), duke respektuar të drejtat e autorit.
- **Kontribut i drejtë i studentëve.** Mbulimi i kostove të digjitalizimit dhe licencimit përmes financimit publik ose një tarife të vogël vjetore fikse për studentët të përfshirë në tarifatat ekzistuese administrative, duke siguruar përballueshmërinë dhe duke zëvendësuar pagesat informale në para të gatshme (cash).
- **Përgjigje e obligueshme përmes email-it.** Profesorët duhet t'u përgjigjen email-eve të studentëve të dërguara nga llogaritë zyrtare të universitetit brenda një afati kohor të arsyeshëm (p.sh. tri ditë pune), duke siguruar komunikim të drejtë.
- **Komunikim para semestrit.** Profesorët duhet t'u dërgojnë të gjithë studentëve të regjistruar një email, para fillimit të çdo semestri, me një përmbledhje (skicë) të shkurtër të lëndës, tekstet shkollore obligative dhe detajet e aksesit për të gjitha materialet e kërkuara. Kjo siguron që studentët të dinë se çfarë pritet prej tyre paraprakisht dhe të mund të përgatiten pa surpriza të minutës së fundit.

4. Fuqizimi dhe mbrojtja e studentëve

- Krijimi i kanaleve të pavarura të raportimit në nivel universitar dhe kombëtar, me mbrojtje të fortë kundër hakmarrjes.
- Ofrimi i trajnimit dhe resurseve për asamblatë dhe sindikatat studentore për të monitoruar praktikën e teksteve shkollore, për të avokuar kundër korrupsionit dhe për të promovuar sjelljen etike akademike.
- Forcimi i zyrave të avokatit të studentëve (ombudsmanit të studentëve) në mënyrë që ata të mund të hetojnë ankesat që lidhen me tekstet shkollore dhe të zbatojnë mjetet juridike.
- Prezantimi i punëtorëve dhe moduleve për studentët mbi citimin e duhur, parandalimin e plagjiaturës dhe etikën e hulumtimit, për të ndërtuar një brez të ri hulumtuesish me integritet.


5. Integriteti dhe mbështetja e hulumtimeve

- Të kërkohet kontrollimi i origjinalitetit për të gjitha tekstet shkollore të autorizuara nga profesorët, para se këto të botohen, me refuzim të rreptë të punimeve që janë plagjiaturë.
- Të ofrohen grante për korrekturë, redaktim dhe botim digjital ose me akses të hapur, duke ulur kostot me të cilat përballen profesorët.
- Të njihen tekstet shkollore të rishikuara nga kolegët (peer-reviewed) dhe të botuara në mënyrë etike në promovimet në karrierë, duke dekurajuar prodhimin masiv të punimeve me cilësi të ulët.
- Të rriten shpenzimet publike për hulumtimin, nga 0.38% e PBB-së aktuale në të paktën 1% në afat të mesëm, me një qëllim afatgjatë për t'iu afruar mesatares së BE-së prej 2.27%.

3. Zbatimi

3.1 Periudha kohore

Zbatimi i propozuar i këtij propozimi politikash ndjek tri faza, të cilat do të sigurojnë që po bëhen ndryshime dhe do të krijojnë një momentum për implementimin e zgjidhjeve afatshkurtra dhe afatgjata. Periudha kohore është mjaft fleksibël, kështu që mund të akomodojë pasiguritë në lidhje me politikën dhe mënyrën e punës së institucioneve në sistemin e arsimit të lartë në Maqedoninë e Veriut.



3.2 Plani i zbatimit

FAZA I (6 muaj - 1 vit) - Ndërtimi i themeleve

Faza e parë do të krijojë **Këshillin Koordinues të Integritetit Akademik**⁹ dhe do të fillojë zbatimin e reformave kyçe. Universitetet do të fillojnë digjitalizimin e teksteve shkollore ekzistuese obligative dhe ngarkimin e tyre në platformat e sigurta universitare, ndërsa të gjitha punimet e reja të autorizuara nga profesorët, të miratuara si literaturë obligative, do të publikohen në format digjital. Komisionet e pavarura të teksteve shkollore do të formohen në nivel fakulteti për të shqyrtuar literaturën obligative dhe për të adresuar konfliktet e mundshme të interesit. Do të futen gjithashtu edhe mekanizma të raportimit anonim për studentët. Do të fillojë hartimi i ndryshimeve në Ligjin për Veprimtarinë Botuese dhe Ligjin për Arsimin e Lartë, së bashku me përgatitjen e ndryshimeve të statuteve, kodeve etike dhe rregullave disiplinore të universitetit.

FAZA II (12 muaj - 24 muaj) - Miratimi dhe zbatimi i plotë

Në fazën e dytë, ndryshimet ligjore të hartuara do të miratohen nga Parlamenti dhe universitetet do t'i harmonizojnë statutet, kodet etike dhe rregullat disiplinore të tyre në përputhje me kornizën e re. Çdo universiteti publik do t'i kërkohet të operojë një platformë digjitale të unifikuar që mbulon të gjitha fakultetet, ku, si tekstet shkollore të sapobotuara, ashtu edhe ato të digjitalizuara të vjetra, do të jenë të disponueshme për studentët përmes hyrjes së tyre në universitet. **Komisionet e pavarura të teksteve shkollore**¹⁰ do të bëhen plotësisht funksionale në të gjitha fakultetet, duke mbikëqyrur politikat e drejta të teksteve shkollore dhe duke monitoruar konfliktet e interesit. Do të vendosen **sisteme për verifikimin e plagjiaturës dhe origjinalitetit**¹¹ për punimet e shkruara nga profesorët. Masat e transparencës, siç janë komunikimi

⁹ Në interes të implementimit të duhur dhe për të eliminuar rreziqet e ndikimit të padrejtë, **Këshilli Koordinues i Integritetit Akademik** do të krijohet si organ qendror që do ta drejtojë procesin. Ai do të përfshijë përfaqësues të universiteteve, asambleve studentore, zyra të ombudsmanëve, Ministrisë së Arsimit, Komisionit Shtetëror Kundër Korrupsionit, organizatave të shoqërisë civile si Forumi për Ndryshime në Arsim dhe ekspertëve akademikë të pavarur. Roli i tij do të jetë të koordinojë aktivitetet, të monitorojë progresin dhe të sigurojë llogaridhënie në të gjitha universitetet.

¹⁰ **Komisionet e pavarura të teksteve shkollore** janë komisione në nivel fakulteti që shqyrtojnë dhe miratojnë tekstet shkollore obligative. Ato përfshijnë profesorë nga departamente të tjera, stafin e bibliotekës dhe përfaqësues të studentëve, duke siguruar që vendimet të jenë transparente, të drejta dhe të lira nga konfliktet e interesit.

¹¹ **Sistemet e kontrollit të plagjiaturës dhe origjinalitetit** janë softuerë dhe procedura shqyrtimi të përdorura nga universitetet për të kontrolluar tekstet shkollore të autorizuara nga profesorët kundrejt databazave akademike globale. Ato sigurojnë që veprat të jenë origjinale, të cituara siç duhet dhe me cilësi të mjaftueshme akademike.


para-semestral i kërkesave të kursit dhe përgjigjet e detyrueshme ndaj emaileve të studentëve, do të bëhen standarde të patjetërsueshme në të gjithë sistemin e arsimit të lartë. Asambletë studentore dhe zyrat e ombudsmanëve të studentëve, do të kenë trajnim sistematik, për të forcuar rolet e tyre në monitorimin dhe mbrojtjen e studentëve.

FAZA III (24 muaj - 36 muaj) - Qëndrueshmëria dhe vlerësimi

Faza përfundimtare do të sigurojë që reformat të zbatohen plotësisht dhe të jenë të qëndrueshme. Fakultetet duhet të paraqesin raporte vjetore mbi të gjitha tekstet shkollore obligative dhe masat e aksesit, të cilat do të verifikohen nga universitetet dhe Këshilli Koordinues. Përmbushja e këtyre do të monitorohet si në nivel institucional ashtu edhe në atë shtetëror. Do të kryhet një evaluim në nivel nacional, për të vlerësuar ndikimin e reformave në uljen e korrupsionit, përmirësimin e aksesit të studentëve dhe forcimin e integritetit të hulumtimit. Shpenzimet publike për hulumtimin do të rriten drejt 1% të PBB-së, duke ofruar mbështetje afatgjatë për botime akademike me cilësi të lartë dhe duke zvogëluar trysnitë që nxisin praktikat korruptive. Të gjitha platformat digjitale, të gjitha ligjet, si dhe rregullat e universitetit do të rishikohen dhe përditësohen periodikisht, duke siguruar që studentët të mbeten të mbrojtur nga korrupsioni në planin afatgjatë.

Në përfundim të kësaj faze, Këshilli Koordinues i Integritetit Akademik do të publikojë një raport gjithëpërfshirës vlerësimi mbi implementimin tre-vjeçar, duke theksuar në mënyrë të hollësishme arritjet, sfidat dhe rekomandimet për veprime të ardhshme.

Resurset e nevojshme dhe burimet



Zbatimi i këtij propozimi kërkon një kombinim të resurseve ligjore, teknike, institucionale dhe financiare. Këto mund të sigurohen përmes buxheteve ekzistuese qeveritare, alokimeve universitare dhe programeve ndërkombëtare për mbështetje:

- Ekspertiza ligjore do të ofrohet nga Ministria e Arsimit dhe Ministria e Drejtësisë, me asistencë teknike të disponueshme përmes Instrumentit të Ndihmës Para-Aderimit të BE-së (IPA III) dhe Këshillit të Evropës.
- Zhvillimi i infrastrukturës digjitale dhe platformës do të financohet nga universitetet me mbështetjen e qeverisë dhe do të plotësohet nga fondet e Planit të Rritjes së BE-së për digjitalizim, nga programet Horizon Europe dhe nga asistenca e mundshme e Bankës Botërore për digjitalizimin e arsimit.
- Trajnimi dhe ndërtimi i kapaciteteve të asambleve studentore, zyrave të ombudsmanëve të studentëve dhe komisioneve të teksteve shkollore do të mbështeten përmes projekteve Erasmus+ për ndërtimin e kapaciteteve, OSBE-së, UNDP-së dhe OJQ-ve lokale.
- Sistemet e monitorimit do të financohen nga buxheti i qeverisë për Inspektoratin Shtetëror të Arsimit dhe Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, me mbështetje të mundshme teknike nga BE-ja dhe OECD-ja.
- Komunikimi dhe avokimi do të kryhen nga asambletë studentore dhe OJQ-të, me mbështetje nga projektet Erasmus+ dhe UNDP-së, që financojnë angazhimin qytetar dhe ndërgjegjësimin kundër korrupsionit.
- Hulumtimi dhe evaluimi do të drejtohen nga institucionet akademike me financim shtetëror, të plotësuara nga grantet kërkimore të BE-së Horizon Europe dhe me mbështetje të herëpashershme nga programet e OECD-së ose Bankës Botërore.

Ky kombinim i burimeve vendore dhe ndërkombëtare bën të mundur që reformat të jenë të qëndrueshme, si në aspektin financiar, ashtu edhe në përputhje me procesin e integritimit në BE.

4. Konkluzioni

Propozimi i politikës "Faqet e pastra" adreson një nga format më persistente dhe dëmtuese të korrupsionit në arsimin e lartë të Maqedonisë së Veriut: kërkesën që studentët të blejnë tekste shkollore të autorizuara nga profesorët, si kusht për avancim akademik. Kjo praktikë cënon integritetin akademik, krijon trysni financiare për studentët, gërryen besimin në universitete dhe ndikon negativisht në universitetet në renditjen e tyre globale.

Propozimi ynë ofron një zgjidhje gjithëpërfshirëse përmes tre proceseve të ndërlidhura: digjitalizimi i teksteve shkollore ekzistuese dhe digjitalizimi i detyrueshëm i teksteve të reja shkollore, reformat ligjore dhe institucionale për të mbyllur boshllëqet rregullatore dhe investimi në integritet dhe cilësi në botimet akademike. Me 5 kategori masash mbështetëse, këto procese mund të krijojnë një sistem transparent dhe të përgjegjshëm, ku qasja në dije është e garantuar, korrupsioni parandalohet dhe hulumtimi mbështetet.

Ndikimi i pritur është i qartë. Studentët do të kenë qasje të barabartë dhe të përballeshme në materialet mësimore, universitetet do të operojnë me rregulla dhe mbikëqyrje më të forta, dhe profesorët do të mbështeten dhe kontrollohen për të botuar punime akademike me cilësi të lartë dhe me integritet. Në planin afatgjatë, arsimi i lartë në Maqedoninë e Veriut do të jetë më transparent, më i besueshëm dhe në përputhje me standardet evropiane.

Ky propozim është në kohën e duhur dhe urgjent. Me integrimin në BE në krye të agjendës shtetërore dhe digjitalizimin që formëson arsimin në të gjithë Evropën, tani është momenti për të vepruar. Faqe të pastra ofron një udhërrëfyes që u sjell dobi studentëve, forcon institucionet dhe rikthen besimin e publikut në arsimin e lartë. Kjo nuk është vetëm një hap drejt eliminimit të korrupsionit që lidhet me tekstet shkollore, por edhe një hap drejt ndërtimit të një sistemi akademik më të drejtë dhe më të qëndrueshëm, që i shërben të gjithë shoqërisë.

5. Referencat

Ligji për Arsimin e Lartë — Gazeta Zyrtare e Maqedonisë së Veriut. Në dispozicion në: [Закон за високо образование](#)

Ligji për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave — Gazeta Zyrtare e Maqedonisë së Veriut. Në dispozicion në: [Закон-за-спречување-на-корупцијата-и-судирот-на-интереси.pdf](#)

Ligji për veprimtarinë kërkimore-shkencore — Gazeta Zyrtare e Maqedonisë së Veriut. Në dispozicion në: [ЕНЕР | Закон за научно-истражувачката дејност](#)

Biblioteka digjitale e Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” (UKIM). Në dispozicion në: [Дигитална библиотека - Универзитет „Св. Кирил и Методиј“ во Скопје](#)

Qasja në e-Library të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” (UKIM). Në dispozicion në: [e-Library UKIM Access - Универзитет „Св. Кирил и Методиј“ во Скопје](#)

META.mk “Korrupsioni në arsimin e lartë: Shitja e librave nga ana e profesorëve është fenomeni më i shpeshtë korruptiv.” Publikuar më 22.09.2024, në dispozicion në: [Корупција во високото образование: Продажбата на книги од професori e најчеста коруптивна појава* | Meta.mk](#)

Banka Botërore. Rishikimi i financave publike të Maqedonisë së Veriut. Në dispozicion në: [North Macedonia Public Finance Review](#)

Interreg Europe. “Përafrimi i arsimit të lartë të Maqedonisë së Veriut me trendet evropiane të kërkimit dhe inovacionit” Publikuar më 12.03.2025, në dispozicion në: [Aligning North Macedonia’s Higher Education with European Research & Innovation Trends](#)

